

## DEKLARATË E GRAVE DHE VAJZAVE TË KOMUNITETEVE RURALE

### Një thirrje për t'u zgjuar për eliminimin e pabarazive gjinore në sektorin agro-ushqimor

Ne, 90 pjesëmarrëse, gra dhe vajza nga zonat rurale të bashkive Elbasan, Kolonjë, Korçë dhe Pukë, të përfshira në zinxhirë të ndryshëm të vlerës në sektorin agro-ushqimor, u takuam në Edicionin e katërt të 'Pro Grave Rurale' në komunitetin e vogël rural të Shirgjanit, më 15 tetor 2022 së bashku me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që mbështesin fuqizimin social-ekonomik të grave, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkive, akademisë dhe medias. I jemi mirënjohëse projektit GREAT1 për mbështetjen ndaj Edicionit të 'Pro Grave Rurale' 2022 duke e kthyer në një platformë të qëndrueshme për advokacinë e grave dhe vajzave në zonat rurale të vendit.

***Të ndërgjegjshme se gratë janë aktore të rëndësishme në sektorin agro-ushqimor***, ato mbeten kontribuueset kryesore në sektorin bujqësor dhe rural si dhe në zhvillimin e përgjithshëm social ekonomik të vendit. Nuk mund të ketë progres në asnjë sektor, përfshi edhe sektorin bujqësor dhe rural, nëse nuk fuqizojmë gratë të luftojnë varfërinë dhe përjashtimin social. Barazia gjinore është një parakusht dhe njëherësh objektiv i përpjekjeve dhe nismave për zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik. *Komunitetet rurale duhet të ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë, si gra dhe burra, vajza dhe djem.*

***Duke risjellë në vëmendje se ky tubim organizohet në kohë të krizave të mëdha ekonomike, sociale, politike dhe shëndetësore*** është e nevojshme t'i ndihmojmë aktorët e angazhuar në fuqizimin social-ekonomik të përftojnë një kuptim real dhe të fortë të shqetësimeve, prioritetëve dhe aspiratave tona. Tërmeti i nëntorit të vitit 2019, pandemia përgjatë viteve të fundit, konflikti në Ukrainë, ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre negative në bujqësi dhe zhvillim rural, kriza e çmimeve, solidariteti i dobët shoqëror etj., na i kanë theksuar sfidat dhe kanë thelluar pabarazitë. Ky Edicion shënoi një moment të rëndësishëm për t'u takuar me gratë dhe vajzat nga zonat rurale, për të diskutuar shqetësimet prioritetet si dhe veprimet konkrete që duhet të nxiten dhe të ndërmerren nga institucionet në funksion të mirëqenies së grave dhe vajzave në zonat rurale.

***Jemi të shqetësuara se sektori bujqësor dhe rural nuk po i ndihmon gratë dhe vajzat shqiptare të përmirësojnë statusin social ekonomik*** për shkak të vështirësive dhe sfidave që ato përjetojnë. Këto vështirësi cenojnë produktivitetin dhe potencialin sipërmarrës dhe në të njëjtën kohë gjenerojnë përfitime të pabarabarta për burrat dhe gratë në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor. Edhe pse ne gratë jemi produktive dhe sipërmarrëse po aq sa burrat, kemi më pak akses dhe kontroll në asete dhe burime prodhuese si: tokë, kredi, inpute bujqësore, tregjet dhe zinxhirët e ushqimit me vlera të larta dhe ndaj marrim fitime më të ulëta për prodhimet tona. *Sektori bujqësor dhe rural duhet të ofrojë mundësi dhe përfitime të barabarta si për burrat dhe gratë.*

***Duke theksuar se pabarazitë gjinore në zinxhirët e vlerës agro-ushqimore cenojnë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik***, mbështesim dhe prioritojmë përpjekjet që përfshijnë dhe integrojnë barazinë gjinore në bujqësi dhe zhvillimin rural me synim ngushtimin e hendekut gjinor. Zhvillimi i zinxhirëve agro-ushqimorë me ndjeshmëri gjinore është prioritarë në këtë drejtim për t'u ofruar *grave dhe burrave mundësi dhe përfitime të barabarta përgjatë angazhimit të tyre në hallka të ndryshme të zinxhirit të vlerës agro-ushqimore.*

<sup>1</sup> Projekti 'Fuqizimi i Grave në Zonat Rurale dhe Turizmi' financohet nga Qeveria Italiane dhe zbatohet nga UN Women dhe FAO, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Duke njohur dhe pranuar se pozita aktuale e grave në zhvillimin bujqësor dhe rural, veçanërisht në marketingun e produkteve vendase, është arritur falë guximit të grave për të sfiduar mendësitë patriarkale,** ndajmë me shqetësim të madh ekzistencën dhe efektin negativ të stereotipave gjinorë dhe mendësisë patriarkale në mirëqenien e grave dhe vajzat në zonat rurale në përgjithësi, dhe në sektorin agro-ushqimor në veçanti. Pavarësisht rolit kryesor të grave në sektor, fatkeqësisht ato mbeten shtyllat e padukshme të zhvillimit, që përballen me diskriminim, si pasojë e pabarazisë në vendimmarrje, mentalitetit patriarkal dhe stereotipave gjinorë të dëmshëm dhe ndarje të pabarabartë të kontributit dhe punës së papaguar. Ne, gratë e Elbasanit, Kolonjës, Korçës dhe Pukës bëjmë thirrje për krijimin e solidaritetit mbarëshoqëror për të fuqizuar gratë dhe vajzat në zonat rurale si dhe për barazi dhe drejtësi sociale, veçanërisht në sektorin agro-ushqimor.

**Qasja e pabarabartë mbi të drejtën pronësore, si kontrolli mbi tokën, është shfaqja më e dukshme e mendësisë patriarkale dhe diskriminimit me baza gjinore.** Aksesit dhe kontrollit i pabarabartë ndaj tokës bujqësore - aseti kryesor prodhues për angazhimin e grave në sektorin agro-ushqimor - kufizon përfshirjen tonë në zinxhirët e vlerës agro-ushqimore dhe rrjedhimisht përfitimet e arritura. Për më tepër, mospjesëmarrja e plotë e grave cenon produktivitetin e gjithë zinxhirit të vlerës, duke ndikuar negativisht në zhvillimin social dhe ekonomik të shoqërisë.

**Pavarësisht se ligji në lidhje me pronësinë mbi tokën bujqësore,** thotë se i përket të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore, **në realitet ne gratë nuk e gëzojmë këtë të drejtë.** Certifikatat e pronësisë mbi tokën bujqësore lëshohen vetëm me emrin e përfaqësuesit të familjes, burrave. Kjo pabarazi gjinore është përforcuar nga normat shoqërore në lidhje me rolin që i është atribuar tradicionalisht grave në shoqërinë shqiptare duke ndikuar më tej në qasjen e pabarabartë mbi të drejtën pronësore të tokës bujqësore.

**Ndërgjegjësimi i grave për pasojat e vendimmarrjes së tyre për heqjen dorë nga e drejta e pronës dhe trashëgimia është urgjente.** Një vendimmarrje e tillë i privon gratë nga të drejtat pasurore, kufizon mundësitë për pavarësi ekonomike dhe minimizon hapësirën për të drejta të tjera në familje, sipërmarrje dhe shoqëri.

**I bëjmë thirrje institucioneve ligjzbatuese të zbatojnë në mënyrë efektive ligjin mbi pronësinë e tokës bujqësore,** veçanërisht në lidhje me të drejtat pronësore të grave, si anëtare të familjes bujqësore. Në lidhje me këtë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të gjenerojë të dhëna me bazë gjinore në lidhje me titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore të përfutuara nga gratë, si anëtare të familjes bujqësore, si dhe gratë që kanë hequr dorë nga kjo e drejtë. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të kuptuar zbatimin e ligjit dhe përmasat e fenomenit të heqjes dorë nga trashëgimia mbi tokën bujqësore prej grave dhe vajzave në zonat rurale.

Në përfundim, fuqizimi social-ekonomik i grave dhe vajzave në zonat rurale duhet të nxitet nga **politika dhe instrumente mbështetës që bazohen në evidenca.** Zhvillimi i **zinxhirëve të vlerës me ndjeshmëri gjinore në sektorin agro-ushqimor** është domosdoshmëri dhe prioritet për t'u mbështetur nga politikat publike. Promovimi i **titullit të përbashkët të tokës midis burrit dhe gruas** duhet të bëhet nga të gjithë institucionet ligjzbatuese të pronësisë së tokës dhe aktorët e tjerë mbështetës.

**Eliminimi i pabarazive gjinore është parësor për fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave në zhvillimin bujqësor dhe rural për të bërë të dukshëm kontributin tonë. për të qenë pjesëtare aktive në ekonomi dhe jetë komunitare si dhe përfituese të mundësive të barabarta në familje, sipërmarrje dhe komunitet.**